

SHTATOR 2025

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

TAKIM KONSULTUES ME OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me organizatën “Drejtësi Sociale” zhvilluan një diskutim me ofruesit e ndihmës juridike falas për të kuptuar nevojat e individëve që i përkasin pakicave Rome dhe Egjiptiane për ndihmë juridike falas, si edhe për të kategorizuar këto problematika si një fushë e veçantë në legjislacion.



TAKIME INFORMUESE NË DELVINË, FINIQ DHE SARANDË MBI NDIHMËN JURIDIKE FALAS

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri, zhvilloi takime informuese në Bashkinë Delvinë, Bashkinë Finiq dhe Bashkinë Sarandë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtën për ndihmë juridike falas. Fokusi i këtyre takimeve ishte krijimi i urave të bashkëpunimit ndërmjet DNJF dhe bashkive të vogla, për të siguruar akses të barabartë në drejtësi për çdo qytetar

TAKIM MES DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS DHE AGJENCISË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS KOSOVË

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas priti në një takim Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas Kosovë. Takimi u zhvillua në formën e një diskutimi në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor mbi Ndihmën Juridike Falas në Kosovë.

TRAJNIM ME TEMË: “FORCIMI I NJOHURIVE LIGJORE, TË DREJTAVE TË PUNËS DHE AFTËSISË SË INFORMIMIT PËR PUNONJËSIT E QENDRAVE TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS”

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas organizuan trajnimin me temë: “Forcimi i njohurive ligjore, të drejtave të punës dhe aftësisë së informimit për punonjësit e Qendrave të Ndihmës Juridike Falas.



VIZITË E DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS DHE AGJENCISË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS KOSOVË NË QSHNJP ELBASAN

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas së bashku me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas Kosovë zhvilluan një takim pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan. Takimi u fokusua te shkëmbimi i përvojave, me synim rritjen e aksesit në drejtësi për çdo qytetar.



MBËSHTETJA E AKSESIT TË QYTETARËVE NË DREJTËSI NËPËRMJET NDËRMJETËSIMIT NË SHQIPËRI

Përfaqësues nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ishin pjesë e takimit të organizuar në kuadër të projektit “Mbështetja e aksesit të qytetarëve nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri”, në qytetin e Përmetit.



TAKIM ME “FONDACIONIN SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas priti në takim “Fondacionin Shqiptar të Personave me Aftësi të Kufizuara”, ku u theksua bashkëpunimi për zhvillimin e fushatave informuese dhe trajnimin e ofruesve të ndihmës juridike mbi legjislacionin në Shqipëri.



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI MES DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS DHE ORGANIZATËS “DREJTËSI SOCIALE”

U nënshkrua memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet organizatës “Drejtësi Sociale” dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, me synim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe garantimin e aksesit më të gjerë në drejtësi për qytetarët në nevojë.



FORUMI KOMBËTAR “POZITA DHE TË DREJTAT E VIKTIMAVE NË PROCEDIMET PENALE”

Përfaqësues nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas morën pjesë në Forumin Kombëtar me temë: “Pozita dhe të drejtat e viktimave në procedimet penale”, të organizuar nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra”.



TRYEZA E RRUMBULLAKËT “VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT NË AGJENCINË SHETËRORE TË KADASTRËS”

Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore, znj. Patricia Pogaçe, ishte e ftuar në tryezën e rrumbullakët me temë: “Vlerësimi i riskut të integritetit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”.



AKTIVITETE NGA QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Qshnjp Elbasan në datën 02.09.2025 zhvilloi një takim me përfaqësues të fondacionit “Joscelyn” në kuadër të hartimit të një plani veprimi me synim rritjen e numrit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar që ofrojnë ndihmë juridike parësore.



Qshnjp Elbasan organizoi më 8.09.2025 një aktivitet informues “Street Law” për të ndërgjegjësuar qytetarët mbi të drejtën për ndihmë juridike falas dhe shërbimet që ofron, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Bamirësisë.



Qshnjp Elbasan në datën 10.09.2025 zhvilloi një takim me përfaqësues të organizatës “Qendra Shqiptare për Integrimin e Njerëzve në Nevojë” në kuadër të hartimit të një plani veprimi me synim rritjen e numrit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar që ofrojnë ndihmë juridike parësore.



Qshnjp Elbasan në datën 26.09.2025 zhvilloi një takim informues me Kryetarin e Zyrës Përmbarimore, z. Granit Guxho, mbi shërbimet e qendrës dhe ligjin për ndihmën juridike, duke theksuar bashkëpunimin e suksesshëm ndërinstitucional.



Qshnjp Dibër në datën 12.09.2025 organizoi një aktivitet sensibilizues në formën e “Street Law” në Peshkopi, duke informuar qytetarët, veçanërisht pensionistët, mbi përfitimet e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe shërbimet për shtresat në nevojë.



Qshnjp Tiranë në datën 04.09.2025 zhvilloi një aktivitet “Street Law” pranë Bulevardit “Zogu I”, në bashkëpunim me shoqërinë civile, me qëllim informimin e qytetarëve mbi ndihmën juridike falas dhe procedurat për përfitimin e saj, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Bamirësisë.



Qshnjp Tiranë në datën 23.09.2025, në ambientet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, zhvilloi një takim informues me OJF-në “Barazi dhe Përfshirje”, për të inkurajuar përfshirjen e OJF-ve në ofrimin e ndihmës juridike, në zbatim të rekomandimeve për rritjen e numrit të organizatave të autorizuara.

Qshnjp Tiranë në datën 22.09.2025 zhvilloi një aktivitet informues me shpërndarje fletëpalosjesh, në bashkëpunim me shoqërinë civile, për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtën për ndihmë juridike falas dhe mënyrat e aksesimit të saj.



Qshnjp Vlorë në datën 19.09.2025 organizoi një takim informues në Bashkinë Vlorë me OJF-të lokale mbi autorizimin dhe financimin për ofrimin e ndihmës juridike parësore, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së tyre në garantimin e aksesit të barabartë në drejtësi për qytetarët në nevojë.

Qshnjp Vlorë në datën 29.09.2025 mori pjesë në ekspozitën “Përtej plagëve të fshehura të traumës ka jetë”, organizuar nga Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, ku u promovuan piktura nga të mbijetuara të trafikimit dhe u përcollën mesazhe sensibilizuese kundër trafikimit dhe dhunës.



Qshnjp Korçë në datën 03.09.2025 mori pjesë në mbledhjen e grupit ETN për rastet E.L dhe S.L, ku u evidentua nevoja për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, pasi të dyja janë viktimat e dhunës në familje dhe kërkojnë zgjidhje martese.



Qshnjp Korçë në datën 04.09.2025 organizoi një aktivitet “Street Law” me qytetarë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Bamirësisë, duke ofruar informacion mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti, përfituesit, shërbimet dhe vendndodhjen e qendrës.



Qshnjp Korçë dhe **QSHNJP Pogradec**, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve në Bashkitë e Vogla, organizuan një aktivitet “Street Law” në Bashkinë Maliq, për të forcuar bashkëpunimin dhe referimin e rasteve ndërmjet qendrave dhe bashkisë.




Qshnjp Mat mori pjesë në prezantimin e Planit Social 2026-2028 të Bashkisë Mat, duke kontribuar me sugjerime për përfshirjen e strategjive që përmirësojnë aksesin e qytetarëve në shërbime.



Qshnjp Mat në datën 04.09.2025 zhvilloi një aktivitet “Street Law” në ambientet tregtare për të përkujtuar Ditën Ndërkombëtare të Bamirësisë, duke informuar qytetarët për historikun dhe rëndësinë e kësaj dite, e cila nderon kontributin e Shën Nënë Terezës.



Qshnjp Mat në datën 08.09.2025 mori pjesë në takimin e Ekipit Teknik Ndërsektorial pranë Drejtorisë së Shërbimit Social Bashkia Mat, ku u diskutuan rastet e dhunës në familje dhe mbrojtja e fëmijëve nga njësitë administrative përkatëse.



Qshnjp Lezhë dhe QSHNJP Kurbin zhvilloi një aktivitet informues me specialisten e ndihmës ekonomike të njësisë administrative Shënkoll, duke prezantuar ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas.



Qshnjp Lezhë dhe QSHNJP Kurbin zhvilluan një aktivitet informues në Njësinë Administrative Shëngjin, ku prezantuan ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.



Qshnjp Lezhë zhvilloi një takim me znj. Elsa Sulo, Drejtoreshë e OJF-së “Sebastia” nga Laçi, lidhur me autorizimin dhe financimin e OJF-ve, ku u diskutua nevoja për përfshirjen e dhënies së ndihmës juridike falas në statutin e organizatës për të qenë e përshtatshme për autorizim.



Qshnjp Lezhë në datën 26.09.2025 në ambientet e Organizatës “Mary Ward Loreto” zhvilloi një takim informues me znj. Afërdita Gjoni, ku u diskutua mbi kriteret për autorizimin dhe financimin e OJF-ve, si dhe mbi periudhën dhe procedurën e aplikimit në portalin e-Albania.



Qshnjp Përmet dhe QSHNJP Gjirokastrë zhvilluan një takim informues mbi ndihmën juridike falas dhe ndërmjetësimin, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të të moshuarve për të drejtat e tyre dhe aksesin në shërbime ligjore, pranë Qendrës për të Moshuar Gjirokastrë.



Qshnjp Përmet në datën 22.09.2025 ishte pjesë e një takimi të zhvilluar në Bashkinë Përmet, mbi forcimin e kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje, organizuar nga QNL dhe Bashkia Përmet, me pjesëmarrjen e institucioneve vendore dhe aktorëve lokalë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe zbatimit efektiv të legjislacionit.



Qshnjp Fier në datën 08.09.2025 zhvilloi një takim me znj. Laureta Roshin nga OJF “Qendra Platforma Kombëtare për Gratë”, ku u prezantua një plan veprimi për rritjen e numrit të OJF-ve të autorizuara në ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe mundësitë e financimit të tyre.



Qshnjp Fier në datën 15.09.2025, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve në Bashkitë e Vogla, në bashkëpunim me KMD, zhvilloi një takim në Bashkinë Divjakë me sektorin e Shërbimit Social, duke theksuar rëndësinë e referimit të rasteve për ndihmë juridike dhe duke rënë dakord për forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional në funksion të garantimit të aksesit në drejtësi.

Qshnjp Fier në datën 15.09.2025, zhvilloi një takim në Bashkinë Lushnje me sektorin e Shërbimit Social, ku u diskutua mbi referimin e rasteve për ndihmë juridike falas dhe forcimin e komunikimit ndërinstitucional.



Qshnjp Fier në datën 24.09.2025, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve në Bashkitë e Vogla, zhvilloi një takim informues në Njësinë Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë, me përfaqësues lokalë dhe qytetarë, ku u prezantuan shërbimet e ndihmës juridike falas, kategoritë përfituese dhe u trajtuan problematika konkrete me qëllim referimin për ndihmë juridike parësore apo dytësore.

Qshnjp Fier në datën 24.09.2025, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve në Bashkitë e Vogla, zhvilloi një takim në Njësinë Administrative Grabjan, Bashkia Divjakë, me përfaqësues të njësisë dhe komunitetit Rom. Takimi synoi informimin mbi shërbimet ligjore falas dhe kategoritë përfituese.

Qshnjp Fier në datën 26.09.2025 mori pjesë në një takim pranë Bashkisë Fier me temë: “Dhuna ndaj grave në hapësirën digjitale: Menaxhimi efektiv i rasteve dhe mbrojtja e të dhënave personale online”.



Qshnjp Fier në datën 29.09.2025 zhvilloi një takim informues për të drejtat ligjore dhe ndihmën juridike falas sipas ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në Njësinë Administrative Seman.

Qshnjp Pogradec në datën 05.09.2025, në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, organizoi një takim informues, me përfaqësues nga komuniteti e kryesisht shtresa në nevojë, ku u prezantuan shërbimet dhe kriteret e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.




Qshnjp Pogradec në datën 05.09.2025, iu bashkua aktivitetit në Qendrën e të Moshuarve, organizuar në bashkëpunim me Shërbimin Social dhe Burgun e Grave Pojskë, ku morën pjesë rreth 40-50 persona. Gjatë aktivitetit u informuan të pranishmit mbi ndihmën juridike falas.

Qshnjp Pogradec organizoi më një takim me përfaqësues të OJF-ve lokale në ambientet e Zyrës së Ndihmës Ligjore Falas.




Qshnjp Pogradec në datën 26.09.2025 mori pjesë në trajnimin mbi sekretarinë dhe arkivat, organizuar nga Drejtoria Qendrore e Arkivit.

Qshnjp Pogradec në datën 29.09.2025 mori pjesë në mori pjesë në mbledhjen e ETN, thirrur nga Shërbimi Social Shtetëror Pogradec.



Qshnjp Gjirokastrë në datën 02.09.2025 zhvilloi një takim me organizatën MEKZH Gjirokastrë ku u diskutua mbi thellimin e bashkëpunimit për ofrimin e ndihmës juridike falas.





Qshnjp Gjirokastrë në datën 26.09.2025 mori pjesë në një mbledhje ndërinstitucionale për rastin e dhunës në familje mes një çifti të moshuarish.

QSHNJP Tropojë, me ftesë të Bashkisë Tropojë, mori pjesë në takimin për Planin e Integritimit Gjnor. Diskutimi u fokusua në fuqizimin e grave dhe vajzave, eliminimin e pabarazisë gjinore dhe përfshirjen e tyre të barabartë në jetën publike.




QSHNJP Tropojë në datën 12.09.2025 zhvilloi një aktivitet "Street Law" ku qytetarët u njohën me shërbimet që ofrohen pranë Qendrës.

QSHNJP Tropojë në datën 17.09.2025 mori pjesë në takimin e organizuar nga Bashkia Tropojë me anëtarët e Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN), ku shprehu gatishmërinë për të ofruar ndihmë juridike për të miturit në rrezik.



QSHNJP Tropojë zhvilloi një takim me specialistë pranë Komisarariatit të Policisë Tropojë për të diskutuar përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore për viktimat e dhunës që kërkojnë urdhër mbrojtjeje, duke ofruar udhëzime mbi plotësimin e formularëve dhe mbështetje të drejtpërdrejtë nga specialistët e Qendrës.

QSHNJP Tropojë në datën 22.09.2025 zhvilloi një takim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, mbi përjashtimin nga tarifat gjyqësore për viktimat e dhunës që kërkojnë urdhër mbrojtjeje, duke ofruar edhe asistencë për plotësimin e formularit.



QSHNJP Kukës në datën 01.09.2025 mori pjesë në prezantimin e "Skemës Kombëtare të Investimeve 2025", organizuar nga AZHBR, ku pati rol dëgjues dhe interpretues mbi kuadrin ligjor të përfitimeve nga skema.

QSHNJP Kukës në datën 04.09.2025 zhvilloi një takim në Bashkinë Has, ku prezantoi Ligjin nr. 111/2017 dhe shërbimet e saj, si dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit për garantimin e aksesit në drejtësi.



QSHNJP Kukës në datën 16.09.2025 zhvilloi një takim në Njësine Administrative Bicaj, ku prezantoi ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" dhe shërbimet që ofron Qendra.

QSHNJP Kukës në datën 17.09.2025 zhvilloi një takim në Njësine Administrative Malzi, ku prezantoi ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" dhe shërbimet që ofron Qendra.



QSHNJP Kurbin dhe Lezhë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Bamirësisë zhvilluan një aktivitet "Street Law".

